



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 1347/1 Prot.

Tiranë, më 09 / 09 / 2019

**V E N D I M**

Nr. 121 , Datë 09 / 09 / 2019

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 20, datë 13.03.2019<sup>1</sup>, të bërë nga F.A kundër Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH) dhe Drejtorisë së Administrimit të Paketave Shëndetësore dhe Ekzaminimeve Terciare (DAPSHET), ish DSHSUKS, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “bindjes politike<sup>2</sup>”. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, procesverbalin datë 25.03.2019 dhe shpjegimeve të dërguara me e-mail-in<sup>3</sup> datë 25.03.2019, ankuesi në mes të tjerash informon se: *“Që prej vitit 2007 ka qenë i punësuar në pozicione të ndryshme pranë FSDKSH. Me Urdhërin nr.105, datë 22.12.2016 "Për emërim në pozicionin e punës" të Drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve Spitalore Universitare dhe Kontrollit Spitalor është emëruar Specialist Ekonomist në Sektorin e Kontrollit Ekonomiko-Financiar pranë Drejtorisë së Shërbimeve Spitalore Universitare dhe Kontrollit Spitalor (DSHSUKS). Me shkresën nr. 364/2, datë 25.05.2018 është*

<sup>1</sup> Ankesa është dorëzuar në datë 13.03.2019 dhe është plotësuar me shpjegime dhe dokumentacion në datë 25.03.2019.

<sup>2</sup> F.A në vitin 1996 ka qenë N/kryetar i Bashkisë Kukës, dhe në periudhën 2007 ka qenë Sekretar i Përgjithshëm i Institucionit të Prefektit të Qarkut Kukës si propozim i subjektit politik: “Partia Demokratike e Shqipërisë”. Subjekti ankues në datë 02.04.2019 ka dorëzuar pranë Komisionerit, Vërtetimin nr.226, datë 27.03.2019 të Partisë Demokratike, Dega Kukës, në të cilin vërtetohet se F.A ka qenë anëtar i Partisë Demokratike, Dega Kukës nga vitit 1992 e në vazhdim dhe ka përfaqësuar Partinë Demokratike në Komisionet e Qendrave të Votimit, KZAZ dhe në grupe numërimi në disa zgjedhje lokale dhe të përgjithshme.

<sup>3</sup> Në përgjigje të informacionit të kërkuar nga inspektori i çështjes me e-mail-in datë 21.03.2019.

*njoftuar për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, pasi i është suprimuar vendi i punës, për shkak të ristrukturimit. Ankuesi, duke mos rënë dakord me njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, me shkresën nr.433, datë 29.05.2018 i është drejtuar Drejtores së DSHSUKS, për dhënie dokumentacioni, por nuk ka marrë përgjigje. Pasi nuk ka marrë përgjigje, me shkresën datë 10.07.2018, (Kodi Postar RR290345816AA), është ankuar pranë Drejtorit të Përgjithshëm të FSDKSH, në të cilën ka kërkuar anulimin e Urdhërit nr.37 datë 25.05.2018 “Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës” por përsëri nuk ka marrë përgjigje. Ankuesi deklaroi se mosdhënia e përgjigjes ka qenë një provë tjetër se e vetmja arsye e largimit të tij nga puna ka qenë për bindje politike të ndryshme nga ato të drejtuesve të FSDKSH dhe DAPSHET. Procesi i ristrukturimit të institucionit është drejtuar nga E.A, ish Drejtor i Përgjithshëm i FSDKSH dhe L.M ish Drejtor e DSHSUKS (DAPSHET), si persona të evidentur me aktivitet partiak e politik të Partisë Socialiste, i pari nga mënyra e zgjedhjes dhe emërimit në detyra politike si: Kryetar i Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Drejtor i Përgjithshëm FSDKSH, dhe e dyta si komisionere e Partisë Socialiste në të paktën në dy zgjedhjet e fundit. Procesi i përzgjedhjes së punonjësve që do rrinin në punë ishte një proces i pabarabartë, pa kritere si: vjetërsia, kualifikimet, rezultatet, masat disiplinore të marra dhe vlerësimet vjetore të punës etj”.*

Subjekti ankues shpjegon se: “Sipas Vendimit nr.63, datë 25.09.2017 të Këshillit të Administrimit të FSDKSH, “Për numrin e përgjithshëm të punonjësve të Fondit dhe disa ndryshime në organizimin e zyrave vendore”, Sektori i Kontrollit Financiar Spitalor në përbërjen e të cilit ishin 11 punonjës (nga këto 7 ekonomistë dhe 4 juristë), do kalonte pranë Drejtorisë së Kontrollit me emrin, Sektori i Kontrollit të Spitaleve me 9 punonjës. Sipas këtij vendimi sektori transferohej dhe ristrukturimin duhet ta bënte Drejtoria e Përgjithshme e FSDKSH. Kjo nuk u bë dhe ishte e qëllimshme pasi në kohën që ai vashdonte punën, FSDKSH, njoftonte për vende të lira pune për pozicionin ekonomist në Sektorin e Kontrollit Spitalor pranë FSDKSH, kjo sipas shpalljes së dt.29.06.2018 dhe duhej që dokumentacioni të paraqitej me datë 12.07.2018. F.A i është drejtuar me ankesë Drejtorit të FSDKSH me datë 10.07.2018 dhe asnjëherë nuk ka marrë përgjigje, edhe pse dosja e dokumentacionit të tij ka qenë pranë zyrës së burimeve njerëzore në FSDKSH. Ndërkohë që është përdorur standard tjetër për punonjësit, T.B dhe E.L, pasi ato u morën në punë në datën 26.07.2018 në kontrollin spitalor pranë FSDKSH. Me vonë u morën në punë dhe punonjësit, H.T dhe E.K. Të katër këta punonjës kanë filluar punë në vitin 2014, pra nuk kanë vjetërsi, përvojë dhe kualifikime pune të njëjta me F.A. F.A shprehet se të vetmet kritere mbi të cilat janë mbajtur në punë të gjithë punonjësit e Sektorit të Kontrollit të Spitaleve gjatë procesit të ristrukturimit, janë përkatësia partiake e njëjtë, nepotizmi ose lidhjet e tyre shoqërore me L.M dhe E.A si përfaqësues të Partisë Socialiste”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe rikthimin në vendin e punës.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën,

*ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Neni 7 i Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.*

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

**Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:**

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 20, datë 13.03.2019 të F.A u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 395/1, datë 28.03.2019, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga FSDKSH dhe DAPSHET për ankesën e bërë nga F.A si dhe ka kërkuar aktet e poshtëcituar:
  - Kopje të procedurës së emërimit dhe largimit nga detyra të punonjësit F.A.
  - Kopje të përgjigjeve të dhëna ankuesit, për shkresat nr.433, datë 29.05.2018 dhe datë 10.07.2018.
  - Kopje të strukturës dhe organikës së vjetër të Sektorit të Kontrollit Ekonomiko-Financiar, DAPSHET përfshirë përshkrimin e punës dhe kualifikimet e punonjësve për të gjitha pozicionet.
  - Kopje të strukturës dhe organikës së re të Sektorit të Kontrollit të Spitaleve të Drejtorisë së Kontrollit Spitalor, FSDKSH përfshirë përshkrimin e punës dhe kualifikimet e punonjësve për të gjitha pozicionet.
  - Kopje të studimit të bërë mbi ristrukturimin e institucionit dhe kriteret e përdorura për përzgjedhjen e punonjësve që do largoheshin apo ndryshonin pozicionin e punës për shkak të ristrukturimit.
  - Kopje të Statutit dhe Rregullores së Përgjithshme të Funkcionimit të FSDKSH të periudhës Maj 2018.

- Kopje të Vendimit nr. 63, datë 25.09.2017, të Këshillit Administrativ të Fondit.
  - Kopje të Vendimit nr. 14, datë 02.02.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm të FSDKSH.
  - Kopje të Relacionit nr.117/1, prot, datë 11.05.2018 të Komisionit të Ristrukturimit.
  - Kopje të vlerësimit të punës për vitet 2016, 2017 dhe 2018 për të gjithë punonjësit e Sektorit të Kontrollit Ekonomiko-Financiar, DAPSHET.
- Me shkresën kujtesë, nr.395/2, datë 03.05.2019 i është kërkuar përsëri informacioni i datës 28.03.2019, subjektit FSDKSH dhe DAPSHET.

Me shkresën nr. 349, datë 06.05.2019, DAPSHET në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“F.A ka qenë i punësuar me Urdhrin nr. 105, datë 22.12.2016 “Për emërimin në pozicionin e punës” dhe ka lidhur Kontratë Individuale Pune me nr.4356/2, datë 22.12.2016 pranë DSHSUKS, aktualisht DAPSHET, në pozicionin e punës Specialist Ekonomist. Bazuar në Vendimin e Këshillit Administrativ nr.63, datë 25.09.2017, FSDKSH me shkresën nr.631/3, datë 02.02.2018 “Mbi ndryshimin e organikës, strukturës dhe përshkrimeve të punës” ka njoftuar DSHSUKS-në për ndryshimin e organikës dhe strukturës së institucionit. Me miratimin e Strukturës së Re, sektori dhe pozicioni i punës i F.A nuk ekzistonte më në strukturën e DAPSHET. DAPSHET me shkresën nr.364, datë 14.05.2018 ka njoftuar ankuesin F.A të paraqitej në datë 17.05.2018 për të diskutuar lidhur me vazhdimësinë e marrëdhënies së punës. Ndërsa me shkresën nr.364/1, datë 17.05.2018 është mbajtur procesverbal nga Komisioni i Ristrukturimit me ankuesin F.A, të cilit i është komunikuar se i është suprimuar vendi i punës si pasojë e ristrukturimit të DSHSUKS në kuadrin e ristrukturimit të FSDKSH. DAPSHET informon se ankuesi F.A ka ngritur Kërkesë Padi pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë në të cilën ka kërkuar “Pavlefshmëri absolute akti” kundër DAPSHET dhe FSDKSH. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin nr.4625, datë 18.12.2018 ka rrëzuar kërkesë padinë e bërë nga F.A”.*

Me shkresën nr. 1677/3, datë 08.05.2019, FSDKSH në mes të tjerash informoi se: *“Me Vendimin nr.63, datë 25.09.2017 të Këshillit Administrativ, është miratuar numri i përgjithshëm i punonjësve të FSDKSH, duke vendosur pakësimin e numrit total të punonjësve. Në zbatim të këtij vendimi, ka dalë Vendimi nr.14, datë 02.02.2018 i Drejtorit të Përgjithshëm të FSDKSH, me të cilën është vendosur të miratojë strukturën organizative të Drejtorisë së Përgjithshme dhe Zyrave Vendore të Fondit. Kriter në përzgjedhjen e punonjësve, me të cilët u vendos zgjidhja e kontratës së punës ishte fakti i shkrirjes së disa strukturave jo eficiente. Në këto kushte, nga ana e strukturave të Fondit, janë bërë të gjitha veprimet administrative të organizimit dhe vlerësimit të pozicioneve të punës që qëndronin dhe atyre strukturave që do shkriheshin apo pozicione pune brenda strukturave që shkurtoheshin. Ky vlerësim ka kaluar në një vlerësim e gjykim për një kohë të gjatë vetëm me qëllim që nga ana e Fondit të kishte një vendimmarrje sa më efektive për institucionin në mënyrë që me burime njerëzore më të pakta të arrijë realizimin e detyrave dhe misionit të përcaktuar nga ligji që rregullon veprimtarinë e institucionit, por nga ana tjetër është treguar kujdesi maksimal në lidhje me problemin social që krijohet nga këto shkurtime të domosdoshme e që njëkohësisht janë shkurtime që bazohen në një shkak të ligjshëm, por që*

*kërkojnë zgjidhjen e kontratave të punës me punëmarrësit në mënyrë të njëanshme dhe konform dispozitave ligjore. Zbatimi i strukturave të reja është njëkohësisht dhe një detyrë ligjore për Fondin, pasi Vendimet e Këshillit Administrativ janë vendimet e organit më të lartë vendimmarrës që drejton këtë institucion. Në këto kushte, si për punonjës të tjerë dhe për F.A është ndjekur procedura ligjore për zgjidhjen e kontratës së punës për shkak të ristrukturimit të Fondit. Me miratimin e Strukturës së Re, sektori dhe pozicioni i punës i F.A nuk ekzistonte më në strukturën e DAPSHET”.*

- Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës nr. 20, datë 13.03.2019, Komisioneri me shkresën nr. 896, datë 07.06.2019 njoftoi palët për zhvillimin e seancës dëgjimore më datë 13.06.2019 duke kërkuar shpjegime dhe kopje të dokumenteve si më poshtë:
  - Përshkrimin e punës dhe kualifikimet për pozicionin e punës që mbante F.A, specialist ekonomist në Sektorin e Kontrollit Ekonomiko-Financiar pranë Drejtorisë së DSHSUKS.
  - Përshkrimin e punës dhe kualifikimet e punonjësve të Sektorit të Kontrollit të Spitaleve në Drejtorinë e Kontrollit në FSDKSH sipas strukturës së re.
  - Kopje të plotë të procedurës së marrjes në punë të të gjithë punonjësve të Sektorit të Kontrollit të Spitaleve në Drejtorinë e Kontrollit në FSDKSH, duke përfshirë procesin nga shpallja e vendit të punës deri në emërimin e punonjësve, në veçanti për punonjësit e përmendur nga subjekti ankues: T.B, E.L, H.T dhe E.K.
  - Kopje të përgjigjeve të dhëna ankuesit, për shkresën nr.433, datë 29.05.2018 “Kërkesë për dhënie dokumentacioni” drejtuar DSHSUKS dhe shkresës datë 10.07.2018 “Kërkesë për anulimin e Urdhrit nr.37, datë 25.05.2018” drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të FSDKSH.
  - Kopje të vlerësimit të punës për vitet 2016, 2017 dhe 2018 për të gjithë punonjësit e Sektorit të Kontrollit Ekonomiko-Financiar, DSHSUKS.

Seanca u zhvillua me praninë e palëve në proces: subjektit ankues, F.A dhe palëve kundër së cilës është paraqitur ankesa, përfaqësuesve me autorizim<sup>4</sup> të FSDKSH dhe DAPSHET, D.L, M.D, A.R dhe P.M.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Gjatë seancës dëgjimore, palët iu qëndruan të njëjtave parashtrime që kishin bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në.

Gjatë seancës dëgjimore, subjekti ankues kërkoi nga Komisioneri që të konstatonte diskriminimin e tij nga ana e FSDKSH dhe DAPSHET, përse i takon largimit të tij nga puna si

---

<sup>4</sup> Me shkresat, nr. 2685/1, datë 12.06.2019 dhe nr. 349/5, datë 12.06.2019.

pasojë e ristrukturimit, pasi procesi ka qenë i pastudiuar, pa vendosur kritere dhe jo transparent, i vërtetuar dhe nga raporti i auditit të Fondit dhe nga Inspektoriati Shtetëror i Punës. Ankuesi theksoi<sup>5</sup> faktin se në datë 17.05.2018 gjatë takimit të zhvilluar në DSHSUKS, lidhur me vazhdimësinë e marrëdhënieve të punës, i ka kërkuar komisionit që të bënte procesin transparent, të vinte në dispozicion dokumentacionin e procesit të ristrukturimit, por nuk ka marrë asnjë përgjigje. Gjithashtu, ankuesi deklaroi se i është drejtuar dhe me shkresë Drejtores së DSHSUKS, në datë 29.05.2018 por përsëri nuk ka marrë përgjigje. F.A u shpreh<sup>6</sup> se gjatë periudhës që ishin në marrëdhënie pune, në muajt qershor-korrik 2018, Fondi ka shpallur vendet e lira të punës për të njëjtin pozicion pune që ai dhe kolegët e tij vazhdonin të merrnin rrogën. Ndodhur përpara kësaj situate, në datë 10.07.2018, ankuesi<sup>7</sup> i është drejtuar me shkresë Drejtorit të Përgjithshëm të FSDKSH, në të cilin ka evidentuar shkeljet ligjore që po bëheshin duke përfshirë shkeljet sipas nenit 9 të Kodit të Punës dhe sipas Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Gjithashtu në këtë shkresë ankuesi deklaroi<sup>8</sup> se i ka bërë më dije drejtorit se dosja me dokumentacionin personal të tij ndodhej pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të FSDKSH, por nuk ka marrë asnjë përgjigje për ankesën e bërë brenda afateve ligjore, pasi nëse kjo shkresë do shqyrtohej sipas procedurave, do kishte marrë përgjigje dhe pretendimi për diskriminim dhe kërkesa për transferim në Sektorin e Kontrollit të Spitaleve në Fond. F.A gjatë seancës dëgjimore deklaroi se janë mbajtur në punë punonjës që kanë bindje dhe aktivitet politik të njëjtë me drejtuesit e institucionit, E.A dhe L.M. Kështu<sup>9</sup>, vazhdojnë marrëdhëniet e punës: H.T i cili ka qenë Kryetar Komune si përfaqësues i Partisë Socialiste, E.K i cili ka familjarë të tij si drejtues të Partisë Socialiste në Njësisë 5, Tiranë dhe E.L e cila ka punuar rreth një vit në sektor dhe ka familjarë të saj të lidhur me Partinë Socialiste.

Nga ana e përfaqësuesve të FSDKSH, u theksua fakti<sup>10</sup> se të gjithë punonjësit e Sektorit të Kontrollit Financiar Spitalor pranë DSHSUKS janë njoftuar për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për shkak të ristrukturimit dhe plotësimi me punonjës të Sektorit të Kontrollit të Spitaleve pranë Fondit është kryer me konkurim të hapur dhe kanë pasur të drejtë të konkurronin të gjithë personat që kërkonin të punësoheshin duke plotësuar dhe kërkesën specifike për pozicionin e punës. Gjithashtu, përfaqësuesit deklaruan<sup>11</sup> se nuk ka pasur diskriminim për shkak të bindjes politike, pasi F.A ka mbi 10 vjet e 8 muaj në institucion, ka filluar punë në institucion që në periudhën kur në pushtet ka qenë Partia Demokratike, ndërkohë që në vitin 2013 erdhi në pushtet Partia Socialiste, dhe ankuesi ka 5 vjet që është në marrëdhënie pune dhe po të ishte bindja politike do ishte marrë masa më përpara. Në seancë dëgjimore u deklarua<sup>12</sup> se nuk ka një shkresë ankesë të protokolluar dhe nuk ka të depozituar për konkurim një kërkesë specifike dhe dosjen personale të F.A. Lidhur me komandimin e T.B dhe jo të F.A në pozicionin si specialist në

<sup>5</sup> Referuar deklaramit gjatë seancës dëgjimore, min 10.50.

<sup>6</sup> Referuar deklaramit gjatë seancës dëgjimore, min 12.30.

<sup>7</sup> Referuar deklaramit gjatë seancës dëgjimore, min 13.20.

<sup>8</sup> Referuar deklaramit gjatë seancës dëgjimore, min 14.19, 37.30.

<sup>9</sup> Referuar deklaramit gjatë seancës dëgjimore, min 26.20.

<sup>10</sup> Referuar deklaramit gjatë seancës dëgjimore, min 31.40.

<sup>11</sup> Referuar deklaramit gjatë seancës dëgjimore, min 35.30.

<sup>12</sup> Referuar deklaramit gjatë seancës dëgjimore, min 37.17.



Sektorin e Kontrollit të Spitalëve pranë Drejtorisë së Kontrollit në Fond në datë 25.06.2018, përfaqësuesit e FSDKSH deklaruan<sup>13</sup> se, është komanduar T.B për arsye se T.B-s i kishte përfunduar periudha e njoftimit, ndërsa F.A i përfundonin marrëdhëniet e punës në muajin gusht.

- Në vijim të procedurës dhe kërkesave të lëna gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore, lidhur me pretendimin e ankuesit se i është drejtuar me shkresë/kërkesë ish-Drejtorit të Përgjithshëm të Fondit, në të cilën ka paraqitur kërkesë për punësim, transferim dhe pretendim për diskriminim, FSDKSH me shkresën nr. 2685/2, datë 20.06.2019, në mes të tjerash ka informuar Komisionerin se: *“Pranë Fondit ka ardhur shkresa e pretenduar e F.A e protokolluar me nr.2685/1, datë 12.06.2019. Në përfundim të shkeljeve të pretenduara nga ankuesi janë vendosur nenet e pretenduara të shkelura nga Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe citohet dhe Neni 9 “Ndalimi i diskriminimit”. Në lidhje me këtë dispozitë të pretenduar nga ankuesi, nuk është paraqitur asnjë referencë në lidhje me shkaqet apo faktet për të cilat ankuesi pretendon se është diskriminuar, duke pasur parasysh këtu pikën 2, të nenit 9, të Kodit të Punës. Në këto kushte, nga ana e Fondit është konstatuar se nuk qëndron pretendimi i ankuesit se ka paraqitur një shkresë specifike për diskriminim në Fond apo DAPSHET”.*

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

#### **A. Lidhur me trajtimin disfavorizues dhe të pabarabartë.**

Bazuar në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, rezultoi se:

F.A që nga data 01.09.2007 deri në datë 25.08.2018 ka qenë në marrëdhënie punësimi, në detyra të ndryshme, pranë Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, aktualisht, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor. Referuar librezës së punës të ankuesit, rezulton se F.A nga data 10.12.2009 deri në datë 30.12.2013 ka qenë në detyrën e Përgjegjës të Sektorit të Kontrollit Spitalor pranë Fondit. Nga data 30.12.2013 deri në datë 22.12.2016 ka punuar në detyrën si specialist ekonomist në Drejtorinë e Auditit të Brendshëm, pranë Fondit. Me Urdhërin nr.105, datë 22.12.2016 “Për emërim në pozicionin e punës” të Drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve Spitalore Universitare dhe Kontrollit Spitalor është emëruar Specialist Ekonomist në Sektorin e Kontrollit Ekonomiko-Financiar pranë Drejtorisë së Shërbimeve Spitalore Universitare dhe Kontrollit Spitalor (DSHSUKS), dhe mes palëve është lidhur Kontrata Individuale e Punës me nr.4356/2, datë 22.12.2016. Me Vendimin nr. 63, datë 25.09.2017 të Këshillit Administrativ, është miratuar pakësimi me 163 punonjës të FSDKSH, duke e bërë

<sup>13</sup> Referuar deklaramit gjatë seancës dëgjimore, min 55.45.

numrin e përgjithshëm të punonjësve të FSDKSH, në 592. Në zbatim të vendimit të sipërpërmendur, ka dalë Vendimi nr.14, datë 02.02.2018 i Drejtorit të Përgjithshëm të FSDKSH “Për miratimin e strukturës organizative, strukturës së brendshme dhe të rregullores për organizimin, funksionimin dhe përshkrimin e punës së Fondit të Sigurimit të detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor”.

Referuar pikës 2 të nenit 15 të Statutit të FSDKSH, të miratuar me Vendimin nr. 124, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Statutit të FSDKSH”, të ndryshuar, përcaktohet se, “Personeli i Drejtorisë së Shërbimeve Spitalore Universitare të Fondit, emërohet nga drejtori i drejtorisë”. Bazuar në kompetencën e mësipërme, Komisioneri vlerëson se, Drejtori i DAPSHET ka tagrin ligjor për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës të punonjësve në varësi por nuk ka kompetenca ligjore për emërimin apo transferimin e punonjësve pranë FSDKSH.

**A/1. Lidhur me trajtimin disfavorizues dhe të pabarabartë të pretenduar nga ankuesi, për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, në kuadër të ristrukturimit të bërë nga DAPSHET, ish-DSHSUKS.**

Referuar dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit administrativ, rezulton se në vijim të zbatimit të strukturës së re organizative, FSDKSH me shkresën nr.631/3, datë 02.02.2018 “Mbi ndryshimin e organikës, strukturës dhe përshkrimeve të punës” ka njoftuar DSHSUKS-në për ndryshimin e organikës dhe strukturës së institucionit. Me miratimin e strukturës së re, numri i përgjithshëm i punonjësve të DAPSHET do të ishte 18, nga 63 që ishte sipas Vendimit të Këshillit Administrativ, nr.3, datë 27.01.2017. Bazuar në strukturën e re, Sektori i Kontrollit Ekonomiko-Financiar dhe pozicioni i punës i F.A nuk ekzistonte më në strukturën e DAPSHET. Në këto kushte, Komisioneri gjykon se procesi i ndryshimit struktural të FSDKSH është një proces madhor që ka prekur këtë institucion në tërësinë e tij, duke suprimuar gjithsej 163 vende pune në FSDKSH dhe përkatësisht 45 pozicione pune, pranë DAPSHET, ish DSHSUKS. Ky proces ristrukturimi nuk ka prekur vetëm pozicionin e punës së F.A, por 45 pozicione pune të ndryshme pranë DAPSHET. Referuar relacionit të grupit të ristrukturimit të DAPSHET, nr. 117/5, datë 11.05.2018, në Sektorin e Kontrollit Spitalor Ekonomiko-Financiar me strukturën e re, do të suprimoheshin të gjitha pozicionet e punës për 11 pozicione/punonjës, plan/fakt.

Për sa më sipër, në mënyrë të detajuar, procedura e ndjekur për zgjidhjen e marrëdhënies së punës me ankuesin është iniciuar nëpërmjet shkresës nr.364, datë 14.05.2018 të Drejtorit të DSHSUKS, me të cilën ankuesi është njoftuar të paraqitet në datë 17.05.2018 për të diskutuar lidhur me vazhdimësinë e marrëdhënies së punës. Në vijim, në datë 17.05.2018 është mbajtur procesverbal nga Komisioni i Ristrukturimit me ankuesin F.A, të cilit i është komunikuar se i është suprimuar vendi i punës si pasojë e ristrukturimit të DSHSUKS në kuadrin e ristrukturimit të FSDKSH, mbështetur në Vendimi nr.14, datë 02.02.2018 i Drejtorit të Përgjithshëm të FSDKSH. Gjatë takimit të zhvilluar me Komisionin e Ristrukturimit, ankuesi ka parashtruar kundërshtimet e tij duke pretenduar se, nuk i është vënë në dispozicion struktura e re, studimi për nevojën e shkurtimeve, nuk ka marrë informacion për numrin e punonjësve në kontrollin spitalor



dhe ka shprehur besimin që për kualifikimet dhe vjetërsinë në punë që ka do të rimbetej në detyrë pranë kontrollit spitalor në Fond.

Me Urdhërin nr. 37, datë 25.05.2018, të Drejtorit të DAPSHET, F.A i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës me DSHSUKS, për shkak të ristrukturimit të institucionit. Referuar Urdhërit të sipërpërmendur, është përcaktuar se në zbatim të nenit 143, pika 1 të Kodit të Punës, F.A i ndërpritën marrëdhëniet e punës, pas një periudhe 3 mujore, përkatësisht në datën 25.08.2018. Gjatë kësaj periudhe, ai ka përfutuar 20 orë leje të pagueshme në javë për të kërkuar punë të re, sipas parashikimit të nenit 143, pika 5, të Kodit të Punës. Njëkohësisht, në zbatim të nenit 145 të Kodit të Punës ai ka përfutuar shpërblim për vjetërsi në masën 5 paga, si dhe në zbatim të neneve 92 dhe 94 të Kodit të Punës, F.A ka përfutuar 17 ditë leje vjetore. Në këtë kontekst, Komisioneri nuk konstaton qëndrim të padrejtë të mbajtur ndaj ankuesit nga ana e Drejtorit të DAPSHET.

Ankuesi, duke mos rënë dakord me njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, me shkresën nr. 433, datë 29.05.2018 i është drejtuar Drejtores së DSHSUKS, duke kërkuar dokumentacion informues për procesin e ristrukturimit, por nuk ka marrë asnjë përgjigje.

Duke mos rënë dakord me Vendimin për largimin e tij nga puna, F.A në datë 22.10.2018 i është drejtuar me Kërkesë Padi, Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë në të cilën në mes të tjerash ka kërkuar “Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ, Urdhrit nr.37, datë 25.05.2018 “Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës”” kundër DAPSHET dhe FSDKSH. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin nr.4625, datë 18.12.2018 ka rrëzuar kërkesë padinë e bërë nga F.A. Vendimi nuk ka marrë formë të prerë.

Referuar informacionit të përcjellë nga FSDKSH dhe DAPSHET, lidhur me strukturën aktuale dhe të mëparshme të institucionit, rezulton se sektori ku punonte F.A është suprimuar dhe nuk ekzistonte më në strukturën e DAPSHET, gjë që ka sjellë suprimimin e vendit të punës të F.A dhe të gjithë punonjësve të këtij sektori, dhe për të gjithë punonjësit e këtij sektori, nga ana e DAPSHET, janë ndjekur të njëjtat procedura për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës.

Për sa më sipër, Komisioneri nuk ka tagër të gjykojë mbi nevojat apo procesin e ristrukturimit të një institucioni si FSDKSH, por mbështetur në atributet që i jep ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mund të kryejë konstatim, nëse ankuesi i është nënshtruar apo ekspozuar një qëndrimi të padrejtë, disfavorizues apo të pabarabartë, nga ana e Drejtorit të DAPSHET, në krahasim me punonjës të tjerë që ndodhen në kushte të njëjta apo të ngjashme me të, në kuptim të nenit 7, pika 1 të këtij ligji.

Mbështetur në analizimin e fakteve të sipërpërmendura, Komisioneri vlerëson se nuk ndodhemi në kushtet e trajtimit të pabarabartë të ankuesit, në krahasim me punonjës të tjerë në kushte të njëjta apo të ngjashme, me të, nga ana e Drejtorisë së Administrimit të Paketave Shëndetësore dhe Ekzaminimeve Terциare.

Për sa më sipër, në mungesë të trajtimit të pabarabartë të ankuesit nuk ndodhemi në kushtet e diskriminimit për shkakun e pretenduar nga F.A, nga ana e Drejtueses së Drejtorisë së Administrimit të Paketave Shëndetësore dhe Ekzaminimeve Terciare.

**A/2. Lidhur me trajtimin disfavorizues dhe të pabarabartë të pretenduar nga ankuesi, lidhur me mosmarrjen në shqyrtim të kërkesës e tij datë 10.07.2018, nga ana e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.**

Në vijim të procesit të ristrukturimit, Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve të FSDKSH, me Memon nr. 3205, datë 29.06.2018 drejtuar Sektorit të Marrëdhënieve me Qytetarët ka dërguar njoftimin për publikimin në faqen zyrtare të Fondit të vendeve vakant në Sektorin e Kontrollit të Spitaleve. Referuar njoftimt datë 29.06.2018, janë shpallur 7 vende pune në Sektorin e Kontrollit të Spitaleve si më poshtë: 1 Përgjegjës Mjek/Ekonomist, 1 Mjek, 2 Ekonomistë, 2 Ekonomistë/Mjek dhe 1 Jurist/Ekonomist. Sipas këtij njoftimi të interesuarit duhet të paraqisnin dokumentet pranë Fondit, brenda datës 12.07.2018. Me shkresën nr. 3458, datë 13.07.2018, Drejtori i Përgjithshëm i FSDKSH ka urdhëruar krijimin e Komisionit për vlerësimin e kandidatëve. Referuar dokumenteve të vënë në dispozicion nga FSDKSH, rezulton se në përfundim të procesit të vlerësimit janë shpallur fitues për pozicionet, Specialist Ekonomist në Sektorin e Kontrollit të Spitaleve pranë Drejtorisë së Kontrollit të Fondit këto punonjës: E.L e emëruar me Urdhërin nr. 446, datë 27.07.2018, E.K i emëruar me Urdhërin nr. 447, datë 27.07.2018 dhe H.T i emëruar me Urdhërin nr. 448, datë 27.07.2018. Ndërsa punonjësja T.B me Urdhërin nr. 383, datë 25.06.2018 është komanduar për një periudhë të përkohshme 3-mujore në detyrën e specialistit në Sektorin e Kontrollit të Spitaleve dhe më vonë me Urdhërin nr. 491, datë 07.09.2018 është shpallur fituese dhe është emëruar Përgjegjëse në Sektorin e Studimeve Strategjive të Zhvillimit Shëndetësor pranë Fondit.

Ankuesi, duke u njohur me shpalljen e vendeve të punës, dhe duke mos rënë dakord me Urdhërin nr. 37, datë 25.05.2018, “Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës” të Drejtorit të DAPSHET, me shkresën datë 10.07.2018, të protokolluar pranë FSDKSH me nr. 3444, datë 12.07.2018, i është drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të FSDKSH, në të cilën ka kërkuar anulimin e Urdhërit nr.37 datë 25.05.2018 “Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës” dhe transferimin në Sektorin e Kontrollit të Spitaleve pranë Drejtorisë së Kontrollit në FSDKSH. Në këtë shkresë F.A ka ngritur pretendime se ishte përpara ndërprerjes së marrëdhënieve të punës pa shkaqe të arsyeshme, pasi gjatë këtij procesi nuk kanë të bëjnë me suprimimin e vendeve të punës në Sektorin e Kontrollit Ekonomiko-Financiar Spitalor por me transferimin e kontrollit spitalor nga DSHSUKS, pranë Drejtorisë së Kontrollit në Fond me emërtimin, Sektori i Kontrollit të Spitaleve. Gjithashtu, në këtë shkresë janë parashtruar dhe një sërë kërkesash dhe pretendimesh që kanë të bëjnë me procedurat e ndjekura në lidhje me ristrukturimin, si dhe pretendime përsa i përket mos vendosjes në dispozicion të dokumentacionit në të cilin është bazuar ristrukturimi. Në këtë shkresë, ankuesi ka informuar Drejtorin e Përgjithshëm se dokumentacioni i kërkuar në shpalljen e vendeve të lira të punës në Sektorin e Kontrollit të Spitaleve, të datës 29.06.2018, është në dosjen e tij të personelit pranë sektorit të burimeve njerëzore në FSDKSH, si dhe i ka kërkuar të

bëhej transferimi i tij pranë Drejtorisë së Kontrollit pasi ai vazhdonte të ishte në punë si specialist i kontrollit pranë DSHSUKS. Gjithashtu, në këtë shkresë F.A i ka kërkuar Drejtorit të Përgjithshëm që të merrte masat për ndalimin e paligjshmërisë dhe të diskriminimit duke mbështetur kërkesën e tij, si të bazuar në mes të tjerash, në Nenin 9, “Ndalimi i diskriminimit” të Kodit të Punës, si dhe në Nenin 5, “Ndalimi i diskriminimit”, Neni 7, “Mbrojtja nga diskriminimi”, Neni 12, “Ndalimi i diskriminimit” dhe Nenin 13, “Detyrimet e punëdhënësit” të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Lidhur me sa më sipër, nga ana e FSDKSH u pranua fakti<sup>14</sup> se shkresa e mësipërme ishte depozituar nga ana e ankuesit pranë institucionit, por nuk ishte marrë në konsideratë dhe nuk ishte vlerësuar lidhur me pretendimin për diskriminim të ankuesit dhe mbi procesin e ristrukturimit të Sektorit të Kontrollit Ekonomiko-Financiar Spitalor.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se FSDKSH ka barrën e provës<sup>15</sup> të provojë, që procesi i ristrukturimit dhe i përzgjedhjes së punonjësve për në Sektorin e Kontrollit të Spitaleve në FSDKSH, ka qenë për arsye të ligjshme dhe të justifikuara. Për sa më sipër, FSDKSH justifikohet me faktin se F.A nuk ka depozituar pranë Fondit kërkesën dhe dosjen përkatëse. Gjatë deklarimeve të seancës dëgjimore por dhe referuar shkresës nr. 734, datë 27.08.2018 të DAPSHET, u vërtetua fakti se dosja me dokumentacionin e F.A ndodhej pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore të Fondit por dhe fakti që ankuesi ka vënë në dijeni Drejtorin e Përgjithshëm se dosja e tij ka qenë pranë Fondit dhe ai ka qenë i interesuar për pozicionin e specialistit ekonomist pranë Sektorit të Kontrollit të Spitaleve në FSDKSH.

Komisioneri gjykon, se nëse strukturat e FSDKSH do kishin marrë në shqyrtim dhe do kishin kthyer përgjigje, brenda afateve ligjore, shkresës së ankuesit, datë 10.07.2018, pretendimi i F.A për diskriminim, do kishte marrë zgjidhje.

Dështimi i FSDKSH për të zbatuar një detyrim ligjor të punëdhënësit, rezulton në një veprim të padrejtë për ankuesin. Komisioneri vlerëson se duke iu referuar, arsimit, kualifikimeve dhe vjetërsisë në punë, F.A mund të ishte një kandidat fitues në rast se do bëhej një proces vlerësimi i të gjithë specialistëve ekonomistë të sektorit ku ai punonte.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se F.A, në referencë të nenit 7, pika 1, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, është ekspozuar para një trajtimi të pabarabartë nga ana e FSDKSH, lidhur me mosmarrjen në shqyrtim të kërkesës së tij për diskriminim.

---

<sup>14</sup> Referuar shkresës nr. 2685/2, datë 20.06.2018 të FSDKSH.

<sup>15</sup>Neni 82, pikat 2 dhe 3, të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Proedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar) parashikon: “2. Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj. 3. Në mënyrë që të mbështesin pretendimet e tyre, palët mund t'i bashkëlidhin kërkesës për fillimin e procedurës administrative dokumente ose fakte të ndryshme.”

## **B. Shkaku i mbrojtur.**

Në ankesën e subjektit ankues, pretendohet diskriminim, për shkak të “bindjes politike<sup>16</sup>”, nga ana e FSDKSH dhe DAPSHET.

“Bindja politike”, “është njëri prej shkaqeve, për të cilët, Ligji Nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Në lidhje me pretendimin e ankuesit për diskriminim për shkak të “bindjes politike”, Komisioneri vlerëson se “bindja politike” konsiderohet si një shkak i mbrojtur, pasi jo vetëm parashikohet si i tillë në bazën ligjore të sipërpërmendur, por edhe sepse ekzistojnë prova të mjaftueshme, që e justifikojnë si të tillë.

## **C. Lidhja e trajtimit të padrejtë dhe disfavorizues me shkakun e mbrojtur.**

Mbështetur në provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, rezulton se F.A i është nënshtruar një qëndrimi të pabarabartë dhe disfavorizues nga ana e FSDKSH, pasi mosmarrja në shqyrtim e kërkesës së tij për transferim në Sektorin e Kontrollit Spitalor në Fond, dhe pretendimit të tij për diskriminim në këtë shkresë, ka rezultuar se ka privuar subjektin ankues për të vazhduar marrëdhëniet e punësimit pranë Fondit.

Në nenin 13/1/c) të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikohet se: “Punëdhënësi është i detyruar: c) t’u përgjigjet efektivisht dhe në përputhje me këtë ligj ankimeve të marra për shkak të diskriminimit të kryer nga punëmarrësit e tij, brenda një muaji nga marrja e tyre”.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se nga ana e punëdhënësit, jo vetëm nuk u sollën argumenta ose prova për të hedhur poshtë pretendimin e ankuesit, por FSDKSH është në shkelje flagrante të garancisë ligjore që neni 15 i LMD-së, “Të drejtat e punëmarrësit”, i jep individit/punëmarrësit.

Ky nen ka parashikuar specifikisht, se:

---

<sup>16</sup> F.A në vitin 1996 ka qenë N/kryetar i Bashkisë Kukës, dhe në periudhën 2007 ka qenë Sekretar i Përgjithshëm i Institucionit të Prefektit të Qarkut Kukës si propozim i subjektit politik: “Partia Demokratike e Shqipërisë”. Subjekti ankues në datë 02.04.2019 ka dorëzuar pranë Komisionerit, Vërtetimin nr.226, datë 27.03.2019 të Partisë Demokratike, Dega Kukës, në të cilin vërtetohet se F.A ka qenë anëtar i Partisë Demokratike, Dega Kukës nga vitit 1992 e në vazhdim dhe ka përfaqësuar Partinë Demokratike në Komisionet e Qendrave të Votimit, KZAZ dhe në grupe numërimi në disa zgjedhje lokale dhe të përgjithshme.

*“1. Çdo punëmarrës ka të drejtë të ankohet te punëdhënësi, te Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ose në gjykatë, nëse beson se ka pësuar diskriminim. Kjo dispozitë nuk e kufizon të drejtën e ankimit në institucione të veçanta, të ngritura pranë sektorëve të ndryshëm të punësimit.*

*2. Gjatë periudhës së shqyrtimit të ankesës, punëmarrësi ka të drejtë të vazhdojë punën sipas kushteve të kontratës.*

*3. Punëmarrësi ka të drejtë të marrë informacion në çdo kohë në lidhje me trajtimin e ankesës, si dhe të marrë shpjegime për vendimet e marra nga punëdhënësi, në përgjigje të ankesës së tij, menjëherë pas shqyrtimit.*

*4. Në rast se punëdhënësi nuk merr masa për të hetuar dhe për të zgjidhur ankesën për diskriminim, punëmarrësi që ka bërë ankesën ka të drejtë ta ndërpresë punën, pa humbur të drejtën e pagës, për aq kohë sa është e nevojshme për t’u mbrojtur nga diskriminimi. Punëmarrësi kthen pagën e marrë, sipas këtij neni, në rast se diskriminimi i pretenduar nuk rezulton i vërtetuar me vendim të formës së prerë”.*

Referuar përsa më sipër arrihet në përfundimin se procesi i emërimit të punonjësve të Sektorit të Kontrollit të Spitaleve dhe mosmarrja në shqyrtim e kërkesë/ankesës së F.A, ka qenë për shkak të bindjes politike të ankuesit. Gjithashtu, nga krahasimi me punonjësit e tjerë që rezultuan fitues gjatë procesit të konkurimit me dosje për pozicionet, Specialist Ekonomist në Sektorin e Kontrollit të Spitaleve pranë Drejtorisë së Kontrollit të Fondit, rezulton se H.T, i cili është në kushte të njëjta me ankuesin, në periudhën 2003-2007 ka qenë Kryetar Komune, i zgjedhur nga Partia Socialiste e Shqipërisë.

Për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi gjykon se procesi i emërimit të punonjësve në Sektorin e Kontrollit Financiar pranë Fondit, në dëm të F.A dhe mosmarrja në shqyrtim e ankesës së tij, ka qenë për shkak të bindjes politike të këtij të fundit.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

Kodi i Punës, i ndryshuar, në nenin 9, të tij ka parashikuar se: *“Në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, ndalohet çdo formë diskriminimi, e parashikuar në këtë Kod dhe në legjislacionin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi”.*

Ky parashikim është në të njëjtën frymë me parashikimet ligjore të LMD-së<sup>17</sup>. Ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, është një ligj që rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, si dhe përcakton shkaqet në bazë të cilave ndaj një personi

---

<sup>17</sup> Referuar nenit 3, pika 8,e LMD-së.

mund të ketë diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë. Gjithashtu mbështetur në nenin 12 të ligjit 10221/2010 ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën për punësim, për shkaqet e parashikuara në nenin 1.

Në nenin 12/1/c) të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikohet se: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimit, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.*

Në përfundim për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, vlerëson se nga ana e FSDKSH, nuk u arrit të provohej një përlligje e arsyeshme dhe objektive, lidhur me mosshqyrtimin e kërkesës së F.A për trajtim diskriminues, duke krijuar kështu bindjen se qëndrimi i FSDKSH ndaj tij ishte tendencioz, dhe nga ana tjetër ankuesi provon dhe dokumenton se mbart një prej shkaqeve të mbrojtura nga Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se subjekti ankues, i është nënshtruar trajtimit të padrejtë nga ana e FSDKSH, pikërisht për shkak të bindjes së tij politike.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 9, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), nenin 1, nenin 3, pika 1, nenin 7, pika 1, nenet 12-13-15, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), si dhe nenin 33, pika 10, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e diskriminimit, të shtetasit F.A nga ana e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, për shkak të bindjes politike.
2. Konstatimin e mosdiskriminimit, të shtetasit F.A nga ana e Drejtorisë së Administrimit të Paketave Shëndetësore dhe Ekzaminimeve Terciare, ish Drejtoria e Shërbimeve Spitalore Universitare dhe Kontrollit Spitalor, për shkak të bindjes politike.
3. Në referencë të pikës 1, të këtij vendimi, nga ana e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, të merren masa për rivendosjen e marrëdhënieve të punësimit me F.A.



4. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijani për këtë vendim, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.
5. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10 221, datë 04. 02. 2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
6. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**ROBERT GAJDA**

**KOMISIONER**